



Vendimi Nr.118/23
Datë: 18.12.2023

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 18.12.2023, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve, RWA International Holding GmbH dhe Fortenova Grupa d.d., lidhur me blerjen e 100% të aksioneve dhe (aseteve - pasurit e paluajtshme) të Fortenova Grupa d.d., dhe marrjen e kontrollit të vetëm nga RWA Holding mbi AISLE 40 d.o.o.,

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, më datë; 24.10.2023, ka pranuar kërkesën për Përqendrim, me Nr. Prot. 502/23-01/H, lidhur me blerjen të 100% të aksioneve dhe (aseteve - pasuri e paluajtshme) nga ndërmarrja RWA International Holding GmbH (blerës) FORTENOVA GRUPA d.d. dhe BELJE plus d.o.o, (shitës) i objekteve të Synuara që do të transferohen nëpërmjet një spin - off tek AISLE 40 d.o.o. (Kompani e Synuar).

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar, me datë 23.11.2023
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së, me datë 24.11.2023

Fortenova Grupa d.d., është një shoqëri aksionare e inkuorporuar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Kroacisë, me adresën të regjistruar në Ulica Marijana Cavica 1, Zagreb, e regjistruar në Regjistrin e Gjykatës ekonomike në Zagreb sipas numrit (MBS) 08117914, me aktivitetet e saj, shitja me pakicë, prodhim ushqimor dhe bujqësi.

BELJE plus d.o.o., një kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar që operon në përputhje me ligjet e Republikës së Kroacisë, me adresën e saj të regjistruar në Svetog Ivana Krstitelja 1a, Darda, Kroaci, regjistruar në regjistrin e Gjykatës Ekonomike në Osijek sipas numrit (MBS) 081180395. Aksionar i vetëm është Fortenova Grupa d.d., në cilësinë e shitësit pasi që është pjesë e grupit.

Aksionar i vetëm i AISLE 40 d.o.o., dhe BELJE plus d.o.o. është Fortenova Grupa d.d..

RWA International Holding GmbH, kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Austrisë, me adresën të regjistruar në Raiffeisenstraße 1,2100 Korneuburg, e regjistruar pranë Gjykatës Lokale (Amtsgericht) në Korneuburg me numër të regjistrimit FN 172268 kp.

AISLE 40 d.o.o., një kompani holding në të cilën objektet e synuara do të transferohen. Objektet e synuara përmbajnë një vend prodhimi të ushqimit dhe bujqësisë në qytetin Ivanič – Grad. Ndërmarrja funksionon sipas ligjeve të Republikës së Kroacisë, në seli e saj të regjistruar në Radnička cesta 80 Zagreb, Kroaci.

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim në tregun e brendshëm ka mbi 1,000,000 Euro.
3. Parashtruesi i kërkesës ka për qëllim të ekzekutojnë marrëveshjen e arritur me datë 10 Tetor 2023.

Analiza e Konkurrencës:

Ndërmarrja e synuar (AISLE 40) nuk ka degë të regjistruar në Kosovë, ndërsa kompania blerëse realizon të hyra përmes shitjeve përmes distributorëve të autorizuar. Objektivi i transaksionit të propozuar është rritja e RWA Holding, që ka për qëllim Evropën Qendrore dhe Lindore përmes zgjerimit, intensifikimit dhe prezencës në treg, përmes prodhimit të vetë dhe krijimin e një kompanie ushqimore në Kroaci, që do të ketë një zgjerim të llogarive kryesore ekzistuese në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, qëllimi kryesor është tregtimi bujqësor dhe imputeve në Kroaci. Palët në përqendrim nuk kanë mbivendosje të konsiderueshme horizontale, prandaj transaksioni nuk do çojë në kufizimin, ose shtrembërimin e konkurrencës në Kosovë, në veçanti nuk do të çojë në krijimin ose forcimin e pozitës dominues.

Tregu Përkatës:

Tregu i produktit, përfshin tregun për prodhimin dhe shitjen e ushqimeve të përbërë me përjashtime të ushqimit të peshkut dhe ushqimet për kafshë shtëpiake.

Tregu gjeografik, do të definohet tregu i Kroacisë.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar:

Transaksioni i propozuar do të realizohet kryesisht në tregun gjeografik të Republikës së Kroacisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se palët në përqendrim realizojnë të hyra përmes distributorëve në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të ketë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se transaksioni nuk paraqet efekte negative, në konkurrencë për arsye se ky transaksion/blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominues të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva